




**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

REPUBLIC OF KOSOVO		REPUBLIKA E KOSOVËS	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT		AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY		ANTI-KORRUPSION AGENCIJA	
Dep.		Nr. Prot.	
Dep.	DPK	Prot No	03-03/4515/16
Nr. i faq.		Dita	
Broj stranica	02	Datum	02.12.2016
Nr. pages		Date	
PRISHTINË			

DATË/A:	02/12/2016
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	z. Ismet HYSENI Menaxher i Zyrës së Prokurimit në Ministrinë e Shëndetësisë
CC:	z. Ardian MEHMETAJ U.d. Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë
NGA/OD/FROM:	Shaip HAVOLLI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin " <b>Dislokimi i instalimeve ekzistuese dhe përgatitja e lokacionit për ndërtimin e Klinikës së re të Pediatriisë në QKUK</b> "

*I nderuari z. Hyseni,*

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin " **Dislokimi i instalimeve ekzistuese dhe përgatitja e lokacionit për ndërtimin e Klinikës së re të Pediatriisë në QKUK** " me numër prokurimi: 206 16 234 521, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

### O P I N I O N

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " **Dislokimi i instalimeve ekzistuese dhe përgatitja e lokacionit për ndërtimin e Klinikës së re të Pediatriisë në QKUK** " me numër prokurimi: 206 16 234 521, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për prokurimin publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

## *Arsyetime*

Ministria e Shëndetësisë, përmes zyrës së prokurimit ka përgatitë njoftimin për kontratë me titull " **Dislokimi i instalimeve ekzistuese dhe përgatitja e lokacionit për ndërtimin e Klinikës së re të Pediatriisë në QKUK** " me numër prokurimi: 206 16 234 521i cili është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt.16/11/2016. Divizioni për Parandalimin e Korrupsionit në fushën e Prokurimit Publik (DPKPP) sipas detyrës zyrtare ka identifikuar dhe trajtuar këtë procedurë të prokurimit. Gjatë shqyrtimit dhe ekzaminimit të dokumenteve të dosjes së këtij tenderi, AKK ka hasur në disa dhëna të cilat nuk janë në pajtim me Legjislacionin në fuqi Prokurimit Publik. Agjencia kundër Korrupsionit pasi ka shqyrtuar me kujdes dokumentacionin e ofruar nga ana e Autoritetit kontraktues ka konstatuar faktet si në vijim:

Në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit e cila është përgatitur nga ana e Autoritetit Kontraktues, tek rubrika III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional te pika 1 është kërkuar: Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses projekte në lëmin e ndërtimtarisë gjatë tri viteve të fundit (2013, 2014, 2015) marr së bashku në vlerë prej 600,000.00 euro. Njëri nga projektet të ketë vlerë minimum 300,000.00 euro, dëshmia e kërkuar: Lista e projekteve të përfunduara në lëmin e ndërtimtarisë, gjatë tri viteve të fundit (2013, 2014, 2015) marr së bashku në vlerë prej 600,000 euro. Njëri nga projektet të ketë vlerë minimum 300,000 euro. Kërkesë kjo për të cilën Agjencia konsideron se është diskriminuese dhe kufizon konkurrencën e lire në mesin e Operatorëve Ekonomik.

Bazuar në legjislacioni në fuqi konkretisht nenin 69 Aftësitë Teknike dhe profesionale të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, një Autoritet Kontraktues ka të drejtë që në kuadër të kriterëve të përzgjedhjes të kërkoj listën me të cilën specifikohen të gjitha projektet e punëve dhe aktivitetëve ndërtimore të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, të përcjella me certifikata për kryerje dhe/ose përfundim të kënaqshëm të projekteve më të rëndësishme të punëve dhe aktivitetëve ndërtimore, mirëpo nëse e vendos një kërkesë të tillë, autoriteti kontraktues nuk duhet të bëjë kufizime për vlera të caktuar të një kontrate.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 69 Aftësitë Teknike dhe profesionale të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon korigjimin e gabimeve të kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t'i shmang praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

***Me respekt !***